



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS  
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA  
KOSOVO BAR ASSOCIATION

**Nr. 1062/2022**

**Data: 30.08.2022**

**KËSHILLI DREJTUES I OAK-SË**, në mbështetje të dispozitave të nenit 41, paragrafit 3 nën paragrafi 3.4 të Ligjit Nr.04/L-193 për Avokatinë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 20/31 Maj 2013, Prishtinë), nenit 95, paragrafit 1 me nën paragrafin 1.2 të Statutit të OAK i miratuar me datë 04 Nëntor 2017, në mbledhjen e datës 30.08.2022, miraton këtë:

## **RREGULLORE PËR PËRCAKTIMIN E KOMPETENCAVE DHE PËRGJEGJËSIVE TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS**

### **Kapitulli I - Dispozitat të përgjithshme**

#### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

Me këtë rregullore përcaktohen kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit Mbikëqyrës, mënyra e ushtrimit të kompetencave të përcaktuara me këtë rregullore, format, kontrolli, kriteret dhe afatet e organeve që raportojnë menaxhimin financiar në Këshillin Mbikëqyrës si dhe përcaktimi i procedurave vendimmarrëse, raportuese dhe llojet sanksioneve për mos zbatimin e kësaj rregullore.

#### **Neni 2**

#### **Fushëveprimi**

1. Rregullorja për Përcaktimin e Kompetencave dhe Përgjegjësisë të Këshillit Mbikëqyrës (më tej: "Rregullorja") është akt normativ i cili zbatohet për nevoja të veprimtarisë së Këshillit Mbikëqyrës, përkritazi me ushtrimin e funksioneve që i janë përcaktuar me Statutin e Odës së Avokatëve të Kosovës (më tej: OAK).
2. Për çështjet që lidhen me punën e Këshillit, e që nuk janë të rregulluara me këtë rregullore, në mënyrë të përshtatshme zbatohen aktet tjera normative të OAK-së.

## **Kapitulli II - Përbërja, kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit Mbikëqyrës**

### **Neni 3**

#### **Mandati dhe konstituimi i Këshillit Mbikëqyrës**

1. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 5 anëtarë të cilët zgjedhën nga Kuvendi i OAK-së, me mandat 4 vjeçar me mundësi rizgjedhje vetëm edhe për një mandat tjetër.
2. Mbledhja konstituive thirret jo më larg se 30 ditë nga dita e zgjedhjes së anëtarëve në Kuvendin e OAK-së. Kjo mbledhje thirret nga Kryetari i OAK-së dhe udhëhiqet nga anëtari më i vjetër në moshë deri në zgjedhjen e Kryetarit dhe Nënkyetarit) të Këshillit Mbikëqyrës.
3. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës e zgjedhin kryetarin dhe nënkryetarin me votim të fshehtë, në mbledhjen konstituive me shumicë të thjesht votash të anëtarëve prezent dhe që votojnë. Secili anëtarë ka të drejtë të propozojë dhe të vet propozohet për kryetar dhe nënkryetar.
4. Në rast të mos përmbushjes të përgjegjësisë që janë përcaktuar me këtë rregullore kryetari apo nënkryetari i Këshillit Mbikëqyrës shkarkohen sipas mënyrës së njëjtë të zgjedhjes së tyre. Procedurën për fillimin e shkarkimit të Kryetarit dhe Nënkyetarit mund të propozohet me shkrim së paku prej tre anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, i cili propozim duhet t'i dërgohet Këshillit Mbikëqyrës, 7 ditë para datës së mbajtjes së mbledhjes.
5. Mungesa pa arsye në tri mbledhje radhazi e anëtarëve përbën bazë të mjaftueshme për inicimin e shkarkimit nga Kuvendi i OAK-së.

### **Neni 4**

#### **Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës**

1. Këshilli Mbikëqyrës ka këto kompetenca dhe funksione:
  - 1.1. ushtron mbikëqyrje dhe kontroll lidhur me gjendjen e përgjithshme të afarizmit financiar të OAK, duke përpiluar raport i cili jep konstatime dhe rekomandime mbi masat e nevojshme lidhur me zbatimin e politikave për afarizmin financiar të OAK;
  - 1.2. bënë mbikëqyrjen e zbatimit të detyrimeve financiare në përputhje me aktet normative mbi menaxhimin financiar;

- 1.3. bënë kontrollin e detyrueshëm periodik dhe specifik të afarizmit financiar;
- 1.4. përgatitë raportet të cilat ja prezanton Kuvendit të OAK-së;
- 1.5. për qëllime të ushtrimit të funksionit, Këshilli Mbikëqyrës ka kompetencë të plotë në qasjen e dokumentet financiare të OAK, të cilat dokumente organet përgjegjëse që udhëheqin afarizmin financiar të OAK obligohen që t'ia sigurojnë Këshillit Mbikëqyrës sipas kërkesës së tyre dhe të japin sqarime lidhur me to;
- 1.6. me qëllim të realizimit të mandatit Këshilli sipas nevojës mund të angazhoj ekspert të jashtëm.

## **Neni 5**

### **Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës**

1. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës kanë këto kompetenca dhe përgjegjësi:
  - 1.1. janë përgjegjës për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe akteve të tjera të nxjerra nga Këshillit Mbikëqyrës;
  - 1.2. marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës dhe parashtrojnë propozimet e tyre lidhur me çështjet që trajtohen në këto mbledhje dhe përfshihen në procedurat vendimmarrëse;
  - 1.3. propozojnë plotësim dhe ndryshim të rendit të ditës;
  - 1.4. njoftojnë Kryetarin e Këshillit Mbikëqyrës dhe arsyetojnë për mos pjesëmarrjen në mbledhje;
  - 1.5. përmbahen dhe në rast të ekzistimit të ndonjë rrethane të deklarohen për ekzistimin e mundësisë të konfliktit të interesit; dhe
  - 1.6. kryejnë veprimet të tjera brenda fushëveprimit të Këshillit Mbikëqyrës.

## **Neni 6**

### **Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës**

1. Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
  - 1.1. përfaqëson Këshillit Mbikëqyrës pranë organeve të OAK-së;
  - 1.2. thërret mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës dhe propozon rendin e ditës;
  - 1.3. kryeson mbledhjet dhe kujdeset për mbarëvajtjen e saj;
  - 1.4. kujdeset për zbatimin e drejtë të kësaj rregulloreje, vendimeve dhe akteve normative të tjera të OAK-së brenda fushëveprimit;
  - 1.5. siguron transparencën e punës së Këshillit Mbikëqyrës dhe dokumenteve që i nxjerr;
  - 1.6. nënshkruan vendimet dhe aktet të tjera të miratuara nga Këshillit Mbikëqyrës;

- 1.7. njofton Kuvendin në rast të mungesës së paarsyeshme të anëtarit për 3 herë radhazi, duke i rekomanduar Kuvendit shkarkimin dhe zëvendësimin e tij; si dhe
  - 1.8. kryen dhe ndërmerr veprimet të tjera të nevojshme për funksionalitetin e Këshillit Mbikëqyrës.
2. Në rast të pamundësisë së ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësisë të përcaktuara nga paragrafi 1 i këtij neni, të njëjtat do të ushtrohen nga nënkryetari i Këshillit Mbikëqyrës.

### **Neni 7** **Nënkryetari i Këshillit Mbikëqyrës**

Nënkryetari i ushtron kompetencat e Kryetarit në rast të mungesës së tij.

### **Neni 8** **Mbledhjet e Këshillit**

1. Mbledhjet e rregullta të Këshillit i thërret dhe i udhëheqë kryetari, e në mungesë të tij nënkryetari.
2. Mbledhjet e rregullta i thërret kryetari me propozim të rendit të ditës për mbledhjen e thirrur.
3. Rendi i ditës i dërgohet anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës së bashku me ftesën për mbledhje.
4. Ftesa nga paragrafi 3 i këtij neni duhet t'iu dërgohet me shkrim anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës së paku 7 ditë para mbledhjes së thirrur. Përrjashtimisht në rast se materiali është voluminoz atëherë materiali duhet t'iu dërgohet anëtarëve të KM-s, 15 ditë para mbledhjes së thirrur. Në njoftimin e tillë përcaktohet:
  - 4.1 data e mbajtjes së mbledhjes;
  - 4.2 koha e mbajtjes së mbledhjes;
  - 4.3 vendi i mbajtjes së mbledhjes;
  - 4.4 rendi i ditës për mbledhje; dhe
  - 4.5 materialet për shqyrtim në mbledhje.
5. Në pamundësi të thirrjes së mbledhjes nga Kryetari, mbledhja e rregullt mund të thirret edhe nga Nënkryetari.
6. Mbledhjet e Këshillit mund të mbahen sa herë që të jetë e nevojshme për ushtrimin e kontrollit të afarizmit financiar të OAK-së.

7. Në rast të mungesës të Kryetarit dhe Nënkryetarit, mbledhjet do i kryesojë anëtari në moshën më të vjetër në radhët e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.

### **Neni 9**

#### **Mbledhjet e jashtëzakonshme**

1. Mbledhjet e jashtëzakonshme të Këshillit Mbikëqyrës mund të thirren me kërkesën e të paktën 2 (dy) anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe me ftesë të Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës. Afati për dërgimin e ftesës dhe materialit eventual për mbledhje të jashtëzakonshme është jo më vonë se tri ditë para mbledhjes së jashtëzakonshme të thirrur.
2. E drejta për të thirrur mbledhjen e jashtëzakonshme gjithashtu përfshin të drejtën për caktimin e rendit të ditës për mbledhjen e thirrur.
3. Pikat e caktuara të rendit të ditës për mbledhjet e jashtëzakonshme, nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhjes.

### **Neni 10**

#### **Procesverbalet e mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës**

1. Procesverbali i mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës përfshinë:
  - 1.1. datën dhe vendin e mbledhjes;
  - 1.2. pjesëmarrësit që janë prezent në mbledhje;
  - 1.3. rendin e ditës të aprovuar nga Këshilli Mbikëqyrës;
  - 1.4. çështjet e diskutuara në mbledhje;
  - 1.5. vendimet që janë marrë; dhe
  - 1.6. formën dhe rezultatin e votimeve.
2. Procesverbalet e mbledhjes së mbajtur të Këshillit Mbikëqyrës miratohen në mbledhjen e radhës dhe nënshkruhen nga anëtari i cili udhëheq mbledhjen dhe procesmbajtësi. Procesverbalet ruhen në arkivin e OAK-së.

### **Neni 11**

#### **Kuorumi punues dhe i vendimmarrjes**

1. Këshilli Mbikëqyrës ka kuorum punues kur janë të pranishëm të paktën tre (3) anëtarë.
2. Para çdo vendimmarrje Kryesuesi i mbledhjes duhet të konstatojë kuorumin e mbledhjes.

3. Konsiderohet që në një proces vendimmarrës ka pasur kuorum nëse pjesëmarrës në vendimmarrje kanë qenë së paku tre (3) anëtarë.
4. Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve që marrin pjesë në votim.
5. Në rastet kur numri i votave për dhe kundër janë të barabarta, vota e Kryesuesit të mbledhjes është vendimtare.
6. Në çdo pikë të rendit të ditës, Kryesuesi e hapë diskutimin, e hedh në votim dhe konstaton përmbajtjen e vendimit dhe rezultatin e vendimit.
7. Në rast të ekzistimit të konfliktit të interesit, anëtari i Këshillit Mbikëqyrës ka për obligim që të vetë deklarohet dhe të tërhiqet nga procedura e votimit. Në rast se të mos deklarimit të anëtarit lidhur me ekzistimin e konfliktit të interesit, rrethana e tillë mund të denoncohet nga secili anëtarë i Këshillit Mbikëqyrës. Në rast të denoncimit të tillë Kryesuesi i mbledhjes e hedhë në votim denoncimin e arsyetuar. Në rast të vetë deklarimit apo denoncimit të ekzistimit të konfliktit të interesit, anëtari i Këshillit Mbikëqyrës do të tërhiqet nga votimi.

## **Neni 12**

### **Votimi**

1. Votimi në mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës është i hapur.
2. Përrjashtimisht votimi është i fshehtë në rast kur ka të bëjë me zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarit për një funksion të caktuar.
3. Forma e votimit bëhet përmes votës PËR, KUNDËR dhe ABSTENIM.
4. Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës mund të merren edhe në procedurë qarkulluese. Procedura qarkulluese është procedurë e votimit, në të cilën anëtarët votojnë individualisht, me shkrim, pa qenë e nevojshme mbledhja fizike e Këshillit Mbikëqyrës.

## **Kapitulli III – Mbikëqyrja e menaxhimit financiar**

### **Neni 13**

#### **Ushtrimi i kontrollit**

1. Kontrolli i mbikëqyrjes financiare realizohet përmes qasjes dhe analizës së dokumentacionit relevant financiar që duhet të ofrohet nga organet e OAK-së, pa asnjë përjashtim.

2. Kontrolli i mbikëqyrjes financiare do të përfshijë konstatimin e përputhshmërisë në mes të dokumenteve financiare, veprimeve dhe ekzekutimin konkret financiar në raport me normativën përkatëse të menaxhimit financiar në OAK.
3. Në zbatim të paragrafit 1 të këtij neni, Këshilli Mbikëqyrës mund të kërkoj sqarime dhe prova shtesë, qoftë në formë të shkruar apo edhe në mënyrë verbale përmes deklaratimit në mbledhjen e thirrur nga Këshilli Mbikëqyrës.
4. Këshilli Mbikëqyrës ushtron mbikëqyrjen financiare përmes kontrollit periodik dhe specifik, që rregullohen me dispozitat e veçanta të kësaj Rregulloreje.
5. Në rast se anëtarët e KM kanë nevojë që të angazhojnë ekspert të jashtëm, atëherë i kërkojnë drejtorit ekzekutiv që të kryen procedurat ligjore të angazhimit përmes nënshkrimit të kontratës me ekspertin. Përzgjedhjen e ekspertit e bën vet Këshilli Mbikëqyrës.

#### **Neni 14**

#### **Mënyra e procedimit të dokumentacionit**

1. Organet e OAK-së janë të obliguara që me rastin e ushtrimit të kontrollit periodik dhe specifik, t'i ofrojnë Këshillit Mbikëqyrës të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, e i cili kërkohet nga ky i fundit duke i'a vënë në dispozicion të njëjtit.
2. Sipas kërkesës së Këshillit Mbikëqyrës, organet e OAK-së janë të obliguara që jo më larg se 5 ditë të punës, nga dita që i parashtrohet kërkesa në formë të shkruar, t'i ofroj dokumentacionin dhe sqarimet që kërkohen nga Këshilli.
3. Organet e OAK-së, mund të kërkojnë një afat shtesë prej 5 ditë pune, me qëllim të ofrimit të dokumentacionit dhe sqarimet e kërkuara nga Këshilli, për arsye të ndërlikueshmërisë së çështjes konkrete.
4. Dokumentacioni dhe sqarimet duhet t'i ofrohen në formë të shkruar dhe në kopje të mjaftueshme anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.
5. Dokumentacioni sipas paragrafit 4 të këtij neni, mund t'i dërgohet anëtarëve të Këshillit edhe në formë elektronike.
6. Këshillit Mbikëqyrës ka të drejtë në qasje në të gjithë dokumentacionin financiar, në të gjitha strukturat që funksionojnë në kuadër të OAK-së.

## **Neni 15**

### **Kontrolli periodik**

1. Kontrolli periodik është kontroll i rregullt, të cilin Këshilli e ushtron në baza 4 (katër) mujore.
2. Kontrollin periodik në cilësi të kontrollit të rregullt, Këshilli Mbikëqyrës e bënë me qëllim të ushtrimit të kompetencës financiare.
3. Në çdo 4 (katër) mujor, Këshilli do të draftoj raportet periodike, ndërkaq për çdo përmbyllje të vitit kalendarik do të draftoj raportin vjetor jo më larg se data 15 Shkurt të vitit pasues.
4. Raportet periodike Këshilli Mbikëqyrës do t'i përpiloj në datat kalendarike si në vijim:
  - a. Periudha e parë 01 Janar – 30 Prill, jo më larg se deri më 31 Maj
  - b. Periudha e dytë 01 Maj – 31 Gusht, jo më larg se 30 Shtator
  - c. Periudha e tretë 01 Shtator – 31 Dhjetor, jo më larg se 15 shkurt të vitit pasues.
5. Raportet i dërgohen delegatëve të Kuvendit të OAK-së, në formë të shkruar, përmes postës elektronike apo përmes shërbimit postar.

## **Neni 16**

### **Kontrolli specifik**

1. Kontrolli specifik konsiston në mbikëqyrjen mbi një veprimtari të veçantë financiare të OAK-së, që sipas nevojës urgjente kërkon kontroll jashtë periudhave të rregullta të kontrollit periodik.
2. Kontrolli specifik mund të fillohet me iniciativën e Këshillit Mbikëqyrës apo sipas kërkesës të cilit do organ apo edhe 1/3 e delegatëve të Kuvendit të OAK-së.
3. Kërkesa për kontrollë specifik i dërgohet Këshillit Mbikëqyrës me shkrim, duke përfshirë arsyetimin përkatës. Këshilli Mbikëqyrës në kohë sa më të afërt dhe të arsyeshme do të shqyrtoj kërkesën dhe do të vendos për të, brenda afatit prej 7 ditëve nga pranimi i saj.
4. Kontrolli specifik nuk do të interferoj në kontrollin periodik, ndërkaq të gjeturat në të do të jenë të përfshira në një raport të veçantë. Raporti i tillë do të përfshihet në raportin vjetor të vitit në të cilin është kryer kontrolli specifik.



## **Neni 17**

### **Përmbajtja e raportit**

1. Me rastin e ushtrimit të kontrollit me qëllim të mbikëqyrjes financiare, Këshilli Mbikëqyrës do të përpiloj raportet në formë të shkruar i cili do të përmbaj:
  - 1.1. përshkrimin e shkurtër mbi procedurën e veprimeve të ndërmarra;
  - 1.2. përmbajtjen e kërkesave për qasjen e dokumenteve të kërkuara nga organet;
  - 1.3. përshkrimin e dokumentit të ofruar;
  - 1.4. përshkrimin dhe elaborimin mbi gjendjen ekzistuese;
  - 1.5. krahasimin lidhur me përputhshmërinë e veprimeve financiare me aktet në fuqi;
  - 1.6. konstatimet dhe konkluzioni mbi të gjeturat gjatë kontrollit; si dhe
  - 1.7. rekomandimet mbi veprimet që duhet të ndërmerren nga organet përgjegjëse me qëllim të përmirësimit të menaxhimit financiar.
2. Përmbajtja e raportit të kontrollit nga paragrafi 1 i këtij neni, do të jetë e aplikueshme qoftë për ushtrimin e kontrollit periodik apo të atij specifik.
3. Raportet e kontrollit do t'iu dërgohen palëve të interesit dhe delegatëve të Kuvendit jo me larg se 10 ditë të punës nga miratimi i të njëjtit nga Këshilli Mbikëqyrës.

## **Neni 18**

### **Raportimi në Kuvendin e OAK-së**

1. Raportin vjetor të Këshillit Mbikëqyrës e prezanton Kryetari apo një anëtar i deleguar nga Këshilli, para Kuvendit të OAK-së.
2. Këshilli Mbikëqyrës do të përgatis ekspozë mbi raportet e kontrollit i cili do të prezantohet pranë delegatëve të Kuvendit të OAK-së.
3. Pas ekspozesë së prezantuar, Kuvendi i OAK-së do ta shqyrtoj miratimin e këtij Raporti.
4. Me miratimin e raportit të Këshillit Mbikëqyrës rekomandimet e përfshira në të, do të jenë të obligueshme për zbatim nga organet përgjegjëse lidhur me përmbushjen ose mos përmbushjen e detyrimeve të caktuara që janë konstatuar në bazë të mbikëqyrjes financiare.

5. Në rast të mos miratimit apo miratimit me vërejtje të këtij raporti nga Kuvendi i OAK-së, Këshilli Mbikëqyrës është i obliguar brenda afatit prej 30 ditësh ta përmirësoj raportin sipas vërejtjeve të Kuvendit të OAK-së.
6. Raporti i korrigjuar i dërgohet përsëri Kuvendit, në mbledhjen pasuese të tij.

## **Kapitulli IV - Dispozitat përfundimtare**

### **Neni 19**

#### **Pasojat për moszbatimin e rregullores**

1. Moszbatimi dispozitave të rregullores nga ana e anëtarëve të KM-së dhe të gjithë avokatëve përbën shkelje disiplinore dhe do të trajtohet sipas normativës së OAK-së.
2. Moszbatimi i rregullores nga stafi i OAK-së, do të konsiderohet si shkelje e rëndë e detyrave të punës.

### **Neni 20**

Kjo rregullore miratohet, ndryshohet apo plotësohet nga Këshillit Drejtues i OAK-së.

### **Neni 21**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi dhe zbatohet në ditën e aprovimit të saj nga Këshillit Drejtues i Odës.

Prishtinë, 30.08.2022

**Avokat Behar Ejupi, Kryetar  
Oda e Avokatëve të Kosovës**